

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

| | | | |
|--------|--|--------|-------------------------|
| Për: | Menaxherin e prokurimit Këshilli Gjyqësor i Kosovës OE ankues “Alfa.i” SH.P.K | Kopje: | Paneli Shqyrtues - OSHP |
| Prej: | Es’heme Beka – Ekspert shqyrtues i prokurimit | | |
| Lënda: | Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën me Nr. 294/19 të parashtruar nga OE“Alfa.i” sh.p.k-Lipjan | | |
| Datë | 25.06.2019 | | |

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, ju njoftojmë me raportin, lidhur me ankesën e dt:10.06.2019 me nr. 294/19 të parashtruar nga OE“Alfa.i” sh.p.k –Lipjan lidhur me aktivitetet prokurimit “Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata”me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Këshilli Gjyqësor i Kosovës

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur me këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:


- Autoritetit Kontraktues – Këshilli Gjyqësor i Kosovës(KGJK).
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Alfa.i” sh.p.k –Lipjan lidhur me aktivitetet prokurimit “Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata”me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

| | | | |
|---|--|----------------------------------|------------------------------|
|  | | 12.06.2019 | 25.06.2019 |
| Nënshkrimi i ekspertit | | data e autorizimit të ekspertit. | data e dorëzimit të raportit |

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

1). Me datën: 10.06.2019 OE “Alfa.i” sh.p.k -Lipjan, ka parashtruar ankesë në OSHP , kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata” me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –Këshilli Gjyqësor i Kosovës

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Operatori Ekonomik Ankues “Alfa.i” sh.p.k -Lipjan,

Dispozitat e shkelura sipas OE ankues “Alfa.i” sh.p.k -Lipjan,, janë:

- Neni 7 i LPP-së **Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**
- Neni 59. 4- Ekzaminimi, Vleresimi dhe krahasimi i tendereve;
- Neni 62 i LPP-së
- Neni 44.7 dhe 8 i Rregullave dhe Udhëzuesit operativ për Prokurim Publik(RRUOPP)

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Alfa.i” sh.p.k -Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata” me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).

DEKLARATA DETALE MBI FAKTET DHE ARGUMENTET:

Të nderuar, ne jemi njoftuar me dt:29.05.2019 me vendimin të autoritetit kontraktues për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, ndërsa si arsye e kanë dhënë si një shkelje të ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi.

Ne me dt:30.05.2019 kemi pasur qasje në dokumentet e dy operatorëve ekonomik me çmim me të lirë se ne, tek oferta e OE ENG HOUSE COMPANY SH.P.K- Prishtinë dhe OE AS Tech SH.P.K – PRISHTINË.

Ne si operatorë ekonomik dhe si palë me interes në këtë procedurë, nuk e dime arsyen e saktë se përse është anuluar ky aktivitet i prokurimit dhe se çfarë shkelje e ligjit ka ndodhur, mirpo konsiderojmë se në këtë fazë të aktivitetit të prokurimit nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e parashikuara të nenit 62 të LPP-së dhe në nenin 44.7 dhe 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), prandaj vlersojmë se ky aktivitet i prokurimit është anuluar pa bazë ligjore.

Fillimisht (heren e parë) është rekomanduar për kontratë “ ENG HOUSE COMPANY” SH.P.K- Prishtinë, dhe ne kemi pasur qasje në dokumente dhe njëherit i kemi paralajmëruar AK, se ky operator ekonomik nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, sepse në sqarimin që është dhënë në dosje si në vijim Klimat e reja duhet të jenë me sistem të frohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperaturat e jashtme e kohës është e ulët -10 °C, ne e kemi vërejtur se OE “ ENG HOUSE COMPANY “SH.P.K- Prishtinë, e ka ofruar klimen ku sistemi i ngrohjes mund të funksionoj deri në - 7°C, prandaj ky operator ekonomik është i papërgjegjshëm.

Sa i përket operatorit ekonomik AS Tech SH.P.K – Prishtinë, gjatë qasjes në dokumente të këtij operatori ekonomik, kemi vërejtur se i njëjti nuk e plotëson kërkesën e nenit 9.1 dhe 9.2 të FDT-së në lidhje me Kapacitetin teknik dhe profesional, ku është kërkuar si deshmi dokumentare Katalogu me përshkrime, ndërsa ky operator ekonomik i ka ofruar disa fotografi kopje, e të cilat nuk përmbajnë asnjë përshkrim siç është kërkuar në dosje të tenderit. Pra as fotografitë nuk mund të llogariten si katalog, ndërsa përshkrime nuk ka fare, kurse neni 39.8 i RRUOPP parasheh qartë se është dorëzuar katalogu por mungon specifikacioni teknik për mallrat e ofruara ---Refuzo pa kërkuar informacion të metejshëm.

Duke u bazuar në dëshmitë që cekën me lartë, rezulton se dy operatorët ekonomik me çmim me të lirë se ne, janë të papërgjegjshëm.

Përfundimisht autoriteti kontraktues ka anuluar këtë aktivitet të prokurimit pa asnjë mbështetje ligjore dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 62 të LPP-së dhe me dispozitat e nenit 44.7 dhe 8 të RRUOPP.

Gjithashtu ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë me harmoni me nenin 59 të LPP-së, duke u diskriminuar ne si kompani e përgjegjshme dhe me çmim më të ulët se në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së .

Në vendimin e AK-së të dt.03.06.2019 për refuzim të këtikesës për ridhëqyrtim, AK-ja është munduar që edhe ofertën tonë të paraqet si ofertë të papërgjegjshme, edhe pse ne jemi shpallur si tenderues i passukseshëm me arsyetim se ne nuk i kemi pasur katalogët e nënvizuara, ju njoftojmë se kjo kërkesë nuk ka qenë në dosje të tenderit por kërkesa ka qenë të prezentojmë katalogjet me përshkrime, ku katalogjet tanë i kanë të gjitha përshkrimet siç kërkohet në dosje të tenderit. Gjithashtu procesi i vlerësimit të tenderëve është mbyllur ne momentin e dërgimit të letrave standarde.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “Alfa.i” sh.p.k –Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata” me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).

Ne si operatorë ekonomik i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe nuk kemi ofruar me variante siç bën perpjekje tani AK-ja ta paraqet situatën dhe gjendjen se ne kinse kemi ofruar me variante. Ne i plotësojmë të gjitha specifikimet teknike ashtu siç janë kërkuar.

Në fund kërkojmë nga OSHP-ja, që të nxjerrë:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE Alfa i, si e bazuar

ANULOHET njoftimi dhe vendimi i AK-së për anulim të këtij aktiviteti të prokurimit dhe lënda të kthehet në **Rivlerësim**.

Gjithashtu kërkojmë nga OSHP, që ta detyroni autoritetin kontraktues të bëjë rivlersimin e ofertave sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë, sepse ne si kompani i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë dhe duhet të shpallemi fitues të këtij tenderi.

Procesi i prokurimit:

| | |
|--|---|
| Data e njoftimit për kontratë: | 21.03. 2019 |
| e njoftimit për dhenje të kontratë: | 07.05.2019 |
| Lloji i procedurës së aplikuar: | Procedurë e hapur |
| Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: | furnizim |
| Vlera e parashikuar e kontratës: | 20,000.00 € |
| Kriteri për dhënie të kontratës(N.52): | tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët |
| Afati i fundit për dorëzimin e ofertave: | 16.04.2019 |
| Data e hapjes së ofertave: | 16.04.2019 |
| Data e përfundimit të vlerësimit të ofertave: | 19.04.2019 |
| Data e njoftimit me letrën standarde për tenderues të pa suksesshëm: | 19.04.2019 |
| Data e njoftimit për dhënien e kontratës: | 07.05.2019 |
| Data e kërkesës për rishqyrtim: | 31.05.2019 |
| Data e vendimit të AK-së lidhur me kërkesën për rishqyrtim: | 03.06.2019 |

Kriteret për vlerësim:

| | |
|--|--|
| Kërkesat e përshtatshmërisë: Deklarata nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri sikurse është cekur në nenin 65 të Ligjit LPP-Nr. 04 L-042. | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin e përcaktuar në dosjen e përcaktuar në dosjen e tenderit. |
| Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës. (E obligueshme për fituesin para njoftimit për dhënie të kontratës) | Vërtetimi i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës |
| Dëshmi se kompania (biznesi) nuk është në falimentim ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë të lëshuar nga Gjykata kompetente. (E obligueshme për fituesin para njoftimit për dhënie të kontratës) | Vërtetimi nga gjykata kompetente që dëshmon se kompania nuk është në proces të falimentimit ose nën administrim të dhunshëm gjyqësorë |
| Përshtatshmëria profesionale Regjistrimi i OE në regjistrin profesional, komercial ose korporatës në vendin e themelimit | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit, me totalin e informatave |
| Regjistrimi i numrit fiskal | Kopja e certifikatës së regjistrimit të biznesit, me totalin e informatave |
| Certifikata e TVSH-se | Kopja e certifikatës TVSH-se |
| Kapaciteti ekonomik dhe financiar | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> |
| Kapaciteti teknik dhe profesional Ofertuesi duhet të ofrojë dëshmi se ka të përfunduara së paku dy (2) kontrata të natyrës nënë të bashku me referencë, përgjatë tri viteve të fundit. | <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Lista e kontratave të realizuara së bashku me referencë ose raporte të pranimit |
| Kompanitë ofertuese obligohen të ofrojnë garancinë me shkrim minmum 24 muaj (2 vite). | Një deklaratë e nënshkruar dhe vëlosur nga OE. |
| Të ofrohet katalogu për klimat sipas përshkrimit teknik, me të cilin pajisje klima, Oferton Operatori Ekonomik për KGJK-në, dhe Gjykata. Afati i liferimit Furnizim me Klima për SKGJK dhe Gjykata. | Katalogu me përshkrime Deklaratë e vëlosur dhe nënshkruar ku deklaron afatin e liferimit të kimave |

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

| N r | Operatorët Ekonomik | Vendi | Çmimi € | Vërejtje |
|-----|--|-----------|-----------|----------|
| 1. | ALFA.i SH.P.K | Lipjan | 17996,89€ | JO |
| 2. | 'AS Tech' SH.P.K | Prishtinë | 17650,20€ | JO |
| 3. | N.P.,,Toni-Impex' | Gjilan | 19878,87€ | JO |
| 4. | Grupi i Operatoreve Ekonomik Ger Group SH.P.K | Prishtinë | 18271,12€ | JO |
| 5. | 'ENG HOUSE COMPANY' SH.P.K | Prishtinë | 15335,00€ | JO |

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje, si në vijim:

- Vehbi Behluli– Kryetar i komisionit
- Besnik Ramosaj–Anëtar i komisionit
- Burim Nikçi– Anëtar i komisionit

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisionit në përberje të plotë prej tre (3) anëtarësh për vlerësimin e ofertve kanë bërë vlerësimin konform LPP, nenit 59. Për fitues të kontratës shpallin operatorin ekonomik, 'ENG HOUSE COMPANY' SH.P.K., rr Nebih Gashi nr.3,10000, Prishtinë.Operatori E ekonomik, I cili i plotëson të gjitha kërkesat administrative, teknike dhe ka ofruar çmim me të lirë, të kërkuar në Njoftim për Kontratë dhe Dosje të Tenderit.

OE që kanë dorëzuar tender të përgjegjshëm sipas komisionit vlerësues

| EMRI I OPERATORËVE EKONOMIK QË KANË DORËZUAR TENDER TE PËRGJEGJSHËM | VENDI | Çmimi |
|---|-----------|------------|
| 'ENG HOUSE COMPANY' SH.P.K | Prishtinë | 15.335,00€ |

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE "Alfa.i" sh.p.k –Lipjan lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata" me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).

| | | | | |
|--|--|-----------|-------------------|--|
| | 'AS Tech' SH.P.K | Prishtinë | 17.650,20€ | |
| | ALFA.i SH.P.K | Lipjan | 17.996,89€ | |
| | Grupi i Operatoreve Ekonomik Ger Group SH.P.K | Prishtinë | 18.271,12€ | |

- Komisioni pas ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave, ka ardhë në përfundim se tre OE ofertues janë të përgjegjshëm dhe kanë rekomanduar për kontratë **"ENG HOUSE COMPANY" SH.P.K** Prishtinë, me çmim prej: **15.335,00€**

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "ALFA - I"-Prishtinë.

SQARIM HYRËS

Ne vazhdim eksperti shqyrtues e paraqet rrjedhen e Aktivitetit të Prokurimit "Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata .

21.03.2019 Njoftim per Kontrat
07.05.2019 Njoftim per dhenje te kontrates
13.05.2019 Njoftimi per anulimin e dhenies se kontrates
11.04.2019 Leter Standarde e kerkeses per sqarimin e tenderit --.docx
16.04.2019 Procesverbali i hapjes -shqip.pdf
19.04.2019 Vendimi i AK dhe Letrat Standarde.pdf
23.04.2019 Vendimi per pezullim te procedures.pdf
13.05.2019 Vendimi per pezullim te procedures 13.05.2019.pdf
29.05.2019 NJOFTIM MBI VENDIMIN E AK-29.05.2019.docx
03.06.2019 Pezullimi per AP. Furnizimit dhe monitorimit te Klimave SKGJ.pdf
12.06.2019 Kerkese per zgjatjen e validitetit te dosjes dhe sigurimit te tenderit.pdf

Përgjigje në Pretendimi nr.1

Lidhur me pretendimin e OE ankues,se AK ka anulur pa te drejtë këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa si arsye e kanë dhënë se një shkelje të ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi. Ne si operatorë ekonomik dhe si palë me interes në këtë procedurë, nuk e dime arsyen e saktë se përse është anuluar ky aktivitet i prokurimit dhe se çfarë shkelje e ligjit ka ndodhur, mirpo konsiderojmë se ne këtë fazë të aktivitetit të prokurimit nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e parashikuara të nenit 62 të LPP-së dhe në nenin 44.7 dhe 8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik (RrUOPP), prandaj vlersojmë se ky aktivitet i prokurimit është anuluar pa bazë ligjore.

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin në lënd dhe në njoftimet e publikuara nga AK konstaton se me dt.29.05.2019 është publikuar ne platformen e e-prokurimit njoftimi per anulimin e këtij Aktivitetit të prokurimit ne lidhje me këtë vendim eksperti shqytues ka kërkuar nje sqarim nga AK-ës ku ka marr këtë pergjigjeje:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga OE "Alfa.i" sh.p.k –Lipjan lidhur me aktivitetine prokurimit "Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata"me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).

Citoj: Me dt 29.05.2019 kemi anuluar aktivitetin me arsyetimin se një shkelje e ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi,
Ne njoftim për kontrate dhe dosje tenderit variantet nuk pranohen.

Sqarim

Ne dosjen e tenderit te specifikat teknike te detyrueshme ka qen kërkesë nga njësia kërkuese departamenti I logjistikes.

1.Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C .

Pasi qe janë përfunduar te gjitha procedurat deri te nënshkrimi i kontratës, para nënshkrimi te kontratës, kemi kontrolluar edhe nje here lëndën dhe specifikat teknike, është konstatuar se nga fillimi njësia kërkuese departamenti I logjistikes -është lëshuar një gabim teknik nuk ka asnjë lloj klime ne bote :ultë -10 °C , siç është kërkuar ne D.T. (Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C).

Andaj, me date . 13.05.2019, keni publikuar Njoftimi për anulimin e dhënies se kontratës, arsyetimin se një shkelje e ligjit ka ndodhur dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi. Eshte konstatuar se asnjëra nga ofertat nuk i plotësojnë kerkesen tek specifikat teknike te detyrueshme : Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C .

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në nenin 44.5 pika (ix) e RRUOPP-së ku thot, Procedura e prokurimit ***pas hapjes së ofertave duhet*** të anulohet për një nga arsytet e mëposhtme:

(ix) një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

Eksperti shqyrtues pas shqyrtimit te ofertave sqaron se asnjëri nga OE nuk kan plotsuar kriterin e vendosur ne specifikimet teknike te detyrueshme ku ka qen (Klimat e reja duhet te janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C).

OE I rekomanduar për kontrat tek katalogu me pershkrime ka sjell -7/+24

OE ankues ka sjell disa variante -7/+24, -15/+24,-22/+24

OE “As Tech” sh.p.k nuk e ka pershkrimin per sistemin e ngrohjes dhe ftohjes ne katalogun e ofruar

OE Grupi i Operatoreve Ekonomik Ger Group SH.P.Kka kete pershkrim -15°C≤T≤50°C

Prandaj duke u bazuar ne specifikimin teknik te detyrueshem te vendosur ne dosjen e tenderit AK-ës gjatë përgatitjes e ofertes ka vepruar në kundërshtim me nenin 28 paragrafi 2 duke vendosur nje kriter te tillë ku kufizon konkurencen e OE.

28.2 Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të jenë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

AK edhe pas kërkeses se nje OE për sqarime te dosjes se tenderit ka vepruar ne kundërshtim me nenin 28

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesen e parashtruar nga OE “Alfa.i” sh.p.k –Lipjan lidhur me aktivitetine prokurimit “Furnizimi dhe Montimi i Klimave për SKGJK dhe Gjykata”me nr. të prokurimit: 328/19/1403/1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK).

paragrafi 2 i LPP-së

Kërkesa e OE Citoj : *Te sqarimet është cekur:* Klimat e reja duhet të janë me sistem të ftohjes dhe ngrohjes. Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ulte -10°C. *Ju lutem a mund të specifikoni nëse klimat e kërkuara ju duhen! Inverter apo te thjeshta (d.m.th.pa inverter) e qe edhe ato ngrohën varresisht nga prodhuesi deri kur temperaturat e jashtme janë -5 ose edhe -7°C*

Prandaj AK duke mos e marr parasysh kete kërkes OE per sqarim vazhdon perseri duke dhëne përgjigjeje se Klima duhet te ngrohë deri ne temperaturën -10 °C. Sipas specifikimit teknik.

Perseri AK ka vazhduar me publikimin e njoftimit për dhënje të kontratës për OE “ENG HOUSE COMPANY” SH.P.K i cili ka sjell përshkrim sistemin e ngrohjes -7/+24 e jo siç ka qenë e kërkuar -10 °C duke vepruar në kundërshtim me nenin 7 te LPP-së dhe nenin 59 të LPP-së ku thot:

7.1 Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

59 Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmeja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Dhe pasi qe janë përfunduar te gjitha procedurat deri te nënshkrimi i kontratës AK-ës ka marr vendim për Anulimin e Aktivitetit te Prokurimit me arsyetimin se nje shkelje e ligjit ka ndodh. Duke u bazuar në këto fakte eksperti shqyrtues konstaton se ky pretendim i operatorit ekonomik ankues është **pa i bazuar sepse siç u sqarua edhe me larte OE ankues ka ofertuar me variante (-7/+24, -15/+24,-22/+24 variantet e oferuara nga OE ankeus) dhe siq verehet asnjera nga variantet e oferuara nuk e plotëson kerkese e AK qe Sistemi i ngrohjes duhet të funksionoj edhe kur temperatura e jashtme e kohës është e ultë -10 °C).**

Gjithashtu ekspertja profesionale sqaron se ne njoftimin per kontrate ne piken II.1.7) AK-ja, ka vendosur qe Variantet te mos pranohen.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtuesi propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1), të mbetet ne fuqi Vendimi i Autoritetit kontraktues.